



BASHKIA KOPLIK



PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË BASHKISË KOPLIK

P ë r m b l e d h j e

Përgatitur nga: BASHKIA KOPLIK

Mbështetur nga: Intercooperation Albania, Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor (dldp)
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Shqipëri
URBAPLAN, Zvicer

Financuar nga: SDC – Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Koplík - 2008

Realizimi Grafik: CREOstd

Shtypur në: Botime AFROJDIT



Schweizerische Eidgenossenschaft Swiss Cooperation Office Albania
Confédération suisse
Condeferazione Svizzera
Confederaziun svizra



Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	4
Fjala e Përshëndetjes	5
Çfarë është dhe çfarë përfaqëson Plani Strategjik i Zhvillimit për Bashkinë Koplík?	6
Profili i Bashkisë Koplík	7
Bashkia Koplík në Kontekstin Rajonal	8
Drejtimet e Zhvillimit nga Grupi i Qytetarëve	10
Vizioni i Zhvillimit të Bashkisë Koplík	11
Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Bashkisë Koplík	12
Zhvillimi Ekonomik	13
Menaxhimi i Tokës	14
Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve	15
Forcimi i Qeverisjes së Mirë	16
Mobilizimi i Burimeve Financiare	17
Instrumentat e Menaxhimit të Territorit	18
Forma dhe Metodologjia e Zbatimit të Planit Strategjik të Zhvillimit	20

Hyrje

Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Koplík i paraqitur në këtë dokument vjen në kuadër të **Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor (PDZHL)** në rajonin e Shkodrës, në Veri të Shqipërisë.

Bashkia Koplík është një ndër tetë njësitë partnere të qeverisjes vendore përfutuese të këtij Programi, krahas Bashkisë Shkodër, Bashkive Vau i Dejës, Pukë, Fushë-Arrëz dhe Komunave Velipojë, Dajç dhe Guri i Zi.

Ky Program synon drejt përmirësimit të qeverisjes në nivelin vendor, kryesisht në përmirësimin e strukturave të menaxhimit dhe administrimit, duke mbështetur proceset e decentralizimit të pushtetit si edhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm për njësitë e zgjedhura vendore nëpërmjet bashkërendimit të zhvillimit urban, mbrojtjes së mjedisit si dhe promovimit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.

Hartimi i Planeve Strategjike të Zhvillimit, nëpërmjet proceseve përgatitore transparente me pjesëmarrjen e qytetarëve, përbën një nga komponentët kryesorë të Programit. Qëllimi i këtij procesi është të pajisë autoritetet vendore përkatëse me një dokument bazë strategjik, i cili identifikon prioritetet kyç të zhvillimit për njësinë vendore përfutuese si dhe orienton zhvillimin ekonomik, përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen e shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit etj.

Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Koplík, i paraqitur më poshtë, është hartuar dhe përpunuar/përshtatur nëpërmjet një procesi të hapur me pjesëmarrje, duke angazhuar njësinë administrative vendore në Koplík dhe Grupin e Qytetarëve të cilët janë përfshirë në një cikël seminaresh debatuuese dhe procese të hapura këshillimore me komunitetin vendas.

Ky proces ka përfshirë në mënyrë të veçantë anëtarë të stafit të administratës vendor dhe të këshillit bashkiak Koplík, grupe të ndryshme interesi vendor (biznesmenë, emigrantë, fermerë etj.), përfaqësues të Qarkut Shkodër si një partner në zbatimin e planit në të ardhmen, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse vendore apo organizatave me bazë komunitare në Koplík si edhe partnerë të tjerë të cilët janë duke ushtruar aktivitetin e tyre në territorin e Bashkisë Koplík.



Fjala e Përshëndetjes



Me kënaqësi të veçantë konstatoj finalizimin e një dokumenti të rëndësishëm për Bashkinë tonë, siç është Strategjia e Zhvillimit që po ju paraqesim. Pas një pune të gjatë dhe këmbëngulëse, ne si bashki dhe komunitet jemi krenarë që kemi arritur të finalizojmë një komponent kyç për zhvillimin dhe progresin e njësisë sonë vendore. Për gati një vit e gjysmë, stafi i bashkisë, së bashku me përfaqësues të rëndësishëm të qytetarisë në Koplík, u ulën së bashku për hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm, në të cilin janë kristalizuar të gjitha idetë dhe nismat e nevojshme që duhen ndërmarrë bashkërisht drejt një të ardhmeje më të mirë për Bashkinë tonë.

Puna për të arritur deri këtu nuk ka qenë e pakët dhe duhet thënë që ka qenë përpjekja e përbashkët e stafit administrativ të Bashkisë, e intelektualëve të qytetit, e biznesmenëve, arsimitarëve etj. ajo që bëri të mundur konceptimin e kësaj strategjie të zhvillimit. Dua të falënderoj në mënyrë të veçantë Intercooperation Albania, që financoi dhe mbështeti me ekspertizën e vet të gjithë procesin e gjatë dhe transparent që ne ndoqëm deri në finalizimin e strategjisë. Gjithashtu falënderime shkojnë për grupin e ekspertëve të Co-PLAN, Institutit për Zhvillimin e Habitatit.

Jam i bindur se Bashkia që unë drejtoj dhe i gjithë stafi i saj ka për të punuar maksimalisht për të garantuar zbatimin me përpikëri të objektivave të zhvillimit që ky dokument propozon. Për këtë, unë personalisht si Kryetar i Bashkisë kam përgjegjësinë kryesore, duke respektuar kështu mendimin dhe opinionin e dhjetëra e dhjetëra qytetarëve që u angazhuan me vullnetin e tyre në këtë proces të përbashkët.

Me respekt!

RAMADAN LIKAJ
Kryetar i Bashkisë Koplík

Çfarë është dhe çfarë përfaqëson Plani Strategjik i Zhvillimit për Bashkinë Koplík?

Një kuadër të ri orientimi pune: Që prej formimit dhe funksionimit të Koplíkut si një Bashki, kjo është hera e parë që administrata vendore prodhon strategjinë e saj të zhvillimit, duke shënuar një moment të rëndësishëm që shtron rrugën për një përjasje të organizuar dhe të planifikuar drejt zhvillimit të saj.

Procese të Reja: Ky Plan mund të konceptohet si mekanizmi institucional që përcakton agjendën vendore për zhvillimin e zonës së Koplíkut, politikat dhe veprimet e ardhshme të zhvillimit për t'u ndërmarre. Në këtë kuadër ai nuk është vetëm një produkt por mbi të gjitha një proces që bazohet në nevojat, prioritetet dhe potencialet e identifikuara dhe diskutuara gjatë procesit konsultues

Një Plan Vizionar i Kombinuar: Praktika e planifikimit në vend ka njohur kryesisht thjesht plane rregulluese ose dokumente strategjike zhvillimi (p.sh. strategji zhvillimi qyteti); kjo strategji është një ndërthurje e elementit strategjik vizionar me atë territorial dhe mishërohet jo thjesht në zhvillimin e njëkohshëm me Planin e Përgjithshëm Rregullues, por edhe në përjasjen dhe harmonizimin me të në rrafshin e veprimeve të propozuara për të shënuar vijën e progresit të Koplíkut duke marrë në konsideratë potencialet dhe burimet përkatëse.

Një paketë/skenar i qartë veprimesh: Plani Strategjik i Koplíkut ndërton një kuadër nismash dhe veprimesh konkrete duke përcaktuar aktivitete, duke skeduar përgjegjësitë dhe duke vënë afatet kohore në nivel vendore.

Një Instrument për Zhvillimin e Territorit: Dokumenti i PSZH-së është i pajisur me disa harta specifike që evidentojnë modelet e propozuara të përdorimit të tokës brenda territoreve të Bashkisë Koplík si edhe me skema grafike që orientojnë transformimet e infrastrukturave apo modeleve të përdorimit të tokës në të ardhmen.



Profili i Bashkisë Koplík



Koplíku është një bashki e përmasave relativisht të vogla, në kufirin veriperëndimor të Republikës së Shqipërisë, pranë kufirit me Malin e Zi. Qyteti i Koplíkut ndodhet 17 km nga qyteti i Shkodrës, 18 km nga pika kufitare e Hanit të Hotit me Malin e Zi dhe 116,8 km nga Tirana. Qendra e qytetit të Koplíkut përkon edhe me kryqëzimin e rrugës nacionale Shkodër-Hani i Hotit me rrugën e Malësisë së Madhe. Në veri, Bashkia e Koplíkut kufizohet me Komunën Bajzë, ndërsa në pjesën më të madhe të territorit të vet kufizohet me Komunën Qendër Koplík.

Bashkia ka një sipërfaqe prej 930 hektarësh, nga të cilat 240 Ha janë sipërfaqe urbane – qyteti i Koplíkut. Përveç kësaj, Bashkia e Koplíkut ka nën administrimin e vet 2.7 km të bregut të Liqenit të Shkodrës.

Bashkia dhe Qyteti i Koplíkut shtrihen në fushën e Mbishkodrës, e cila ka një lartësi që varion 5-56 m mbi nivelin e detit dhe që kufizohet në Lindje nga vargmalet e Malësisë së Madhe, ndërsa në perëndim me liqenin e Shkodrës. E gjithë zona ku shtrihet Bashkia dhe qyteti i Koplíkut bën pjesë në basenin e Liqenit të Shkodrës dhe konkretisht në pjesën jugore të deltës së Përroit të Thatë. Vetë qyteti i Koplíkut ndodhet në segmentin rrugor që ndërpritet nga përroi i Rrjollit dhe Përroi i Thatë. Territori në këtë zonë është i sheshtë dhe me një pjerrësi të lehtë që zbrit sipas drejtimit lindje-perëndim, drejt bregut të liqenit.


Bashkia Koplík në Kontekstin Rajonal

E ardhmja e zhvillimit strategjik të Koplíkut duhet parë në varësi dhe në mënyrë të ndërthurur me kontekstin e zhvillimit të integruar të Rajonit të Shkodrës, të zonave urbane dhe rurale të saj, të Liqenit të Shkodrës dhe më gjerësisht, atë ndërkufitar. Bashkërendimi dhe dimensionet e reja të zhvillimit për Koplíkun sjellin në vëmendje disa përparësi të dukshme të tij siç janë: prania e linjave të transportit ndërkombëtar, Liqeni i Shkodrës dhe afërsia me Qytetin e Shkodrës.

Në politikën e administrimit të njësiteve vendore në Shqipëri, gjithnjë e më shumë po ravijëzohet prirje drejt *rajonalizimit* që në rastin konkret orientohen sipas pozicionit të rëndësishëm strategjik, demografik dhe ekonomik që Qyteti i Shkodrës ka në të gjithë rajonin e vet. Koplíku ndodhet i pozicionuar përgjatë rrugës kryesore që lidh Shkodrën me Podgoricën (Mali i Zi). Në këtë aspekt, ai është shumë i favorizuar nga kjo “hapje” dhe shtrirje e zhvillimit që parashtrohet me krijimin e korridorit ndërkufitar, që parashikohet në Strategjinë e Zhvillimit të Rajonit të Shkodrës (EPTISA)³.

Në perspektivën afatgjatë, ky korridor përcaktohet si një aks zhvillimi ku mund të marin formë një sërë aktiviteteve ekonomike duke e vendosur Koplíkun si pjesë të “rajonit urban policentrik ndërkufitar”, të ashtuquajtur “PodShkod”⁴. Në këtë kontekst, Liqeni i Shkodrës, njëherazi më i madhi në Ballkan, jo vetëm që përbën një element natyror me vlerë, por gjithashtu shndërrohet në një bërthamë rreth së cilës do të përqendrohet zhvillimi i këtyre qendrave urbane, duke përfshirë këtu edhe Koplíkun.





Shfrytëzimi i këtij potenciali turistik përbën një ndër burimet e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe social të Rajonit⁵. Ky zhvillim duhet të orientohet sipas principit të balancimit të rritjes së qëndrueshme ekonomike me karakteristikat ekologjike ndërkufitare, duke pasur parasysh se Liqeni i Shkodrës tashmë është përcaktuar nga qeveria shqiptare si një “zonë e veçantë dhe e mbrojtur”. Zona përgjatë bregut të liqenit nga Zogaj në Koplík ka një sipërfaqe afërsisht 20,000 hektarë dhe një perimetër 47km.

Në përputhje me këtë përcaktim rajonal, orientimi i zhvillimit të Koplíkut lidhet me kufizimin e ndërtimeve rezidenciale apo ndalimin e ndërtimeve industriale në aksin rrugor, ndërkohë që të gjitha zhvillimet e tjera në përgjithësi do të duhet të kenë një ndikim minimal në mjedis.

Gjithashtu, ndërveprimi më i ngushtë me qytetin e Shkodrës, nëpërmjet rrugës së referuar si korridori Shkodër-Koplík (Kop-Shkod), pritet të përmirësojë zhvillimin e Koplíkut në fushën e shërbimeve⁶. Megjithatë, një ndër konsideratat në planifikimin e zhvillimit të Koplíkut është eksplorimi i mundësive për zhvillimin e një “qyteti kopsht”, që të ofrojë gjithashtu potenciale për bujqësinë urbane.

Sigurisht që për të ndjekur logjikën e Zhvillimit Policentrik Rajonal është i nevojshëm një bashkërendim i vazhdueshëm në një nivel të ri të përpjekjeve ndërmjet njësive vendore në Rajon dhe sidomos ato njësi të pozicionuara përgjatë korridorit të zhvillimit Shkodër-Podgoricë.

Drejtimit e Zhvillimit nga Grupi i Qytetarëve

1. Promovimi dhe mbështetja e krijimit të zonës industriale-tregtare në veri të bashkisë Koplík, e cila do të shërbejë si një pikë qendrore për rigjallërimin e aktiviteteve ekonomike fitimprurëse në të gjithë territorin e bashkisë.
2. Shfrytëzimi i potencialeve natyrore ekzistuese për promovimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike si: turizmi natyror përgjatë bregut të liqenit të Shkodrës, promovimi i aktiviteteve të qëndrueshme për rritjen e peshkut dhe peshkimit, etj.
3. Zhvillimi i kulturave bujqësore, duke iu referuar traditës në këtë drejtim, si për shembull rigjallërimi i kulturave të duhanit, promovimi i vreshtarisë, pemëve frutore, bimëve eterovajore, etj.
4. Përpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore, nëpërmjet krijimit të një qendre të posaçme të përpunimit në territorin e Bashkisë Koplík e cila do të mundësojë koordinimin e këtij procesi.
5. Zhvillimi i industrisë së përpunimit të rrushit dhe prodhimit të verës.



Vizioni i Zhvillimit të Bashkisë Koplík



Koplíku një qendër e vogël, por e rëndësishme urbane në veri të Shqipërisë; një urë lidhëse për njerëzit, aktivitetet e ndryshme ekonomike dhe shërbimet midis Shkodrës dhe Malit të Zi;

Koplíku si një qytet i zhvilluar ekonomikisht që mbështet shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore që administrohen prej tij, duke u bazuar në traditën e prodhimit të kulturave të vreshtave dhe duhanit, përgjatë brigjeve të bukura të Liqenit të Shkodrës;



Koplíku si një Bashki me burime njerëzore të kualifikuara dhe të ripërtërira, si në nivelin e Administratës Vendore edhe në strukturat e sipërmarrjes së biznesit, kulturës, sportit dhe arsimit; që nxisin krijimin e një klime të favorshme për biznesin vendas dhe të huaj dhe të mundësive për punësim dhe rritje të qëndrueshme të të ardhurave për banorët;



Vizioni ynë për Koplíkun është ai i një vendi të sigurtë, të pastër dhe tërheqës për banorët dhe komunitetet në rritje, të cilët kanë mundësi për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e tyre në bashkëveprim dhe me ndjenjë qytetare si dhe me kapacitetin dhe shtysën për të dhënë kontribut efektiv në të ardhmen e Bashkisë dhe qytetit të Koplíkut.



Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Bashkisë Koplík

A-NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK;

Zhvillimi ekonomik i Bashkisë Koplík duhet të përqendrohet në përmirësimin e klimës së biznesit, promovimin e aktiviteteve vendase të sipërmarrjes si dhe krijimin e një mjedisi tërheqës për investitorët e huaj, nëpërmjet shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

B-NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË TERRITORIT;

Menaxhimi i territorit do të ketë si sfidë kryesore konsolidimin e qendrës urbane të qytetit të Koplíkut, si dhe disiplinimin e ndërtimeve të ardhshme rreth kësaj qendre, duke krijuar dhe forcuar instrumentet e nevojshëm për menaxhimin dhe monitorimin e territoreve urbane dhe rurale

C-NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE;

Rritja e kualitetit të shërbimeve publike dhe infrastrukturës fizike dhe sociale në të gjithë territorin e Bashkisë Koplík

D - NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË QEVERISJES VENDORE;

Rritja e kapaciteteve menaxhuese dhe administruese të Pushtetit Vendor në Bashkinë Koplík, si edhe nxitja e pjesëmarrjes vendore në proceset e vendimmarrjes nëpërmjet ndarjes së informacionit dhe rritjes së transparencës.

F - NË FUSHËN E RITJES SË TË ARDHURAVE VENDORE

Përmirësimi i kapaciteteve të administratës së Bashkisë Koplík në funksion të rritjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore si një domosdoshmëri për zhvillimin dhe rritjen e investimeve në këtë njësi në të ardhmen.



Zhvillimi Ekonomik

- A1. Mbështetja dhe zhvillimi i prodhimit të aktiviteteve bujqësore vendore, duke u fokusuar në kulturat e vreshtarisë, duhanit si dhe pemëve frutore:**
- Evidentimi i potencialeve të prodhimit të këtyre kulturave bujqësore në territorin e Bashkisë Koplík*
 - Përmirësimi i përdorimit të tokës dhe infrastrukturave mbështetëse nëpërmjet një studimi për vlerësimin e nevojave në lidhje me investimet*
 - Rritja e mbështetjes teknike dhe financiare ndaj fermerëve vendas në Koplík*
- A2. Mbështetja dhe zhvillimi i Turizmit Liqenor duke u mbështetur në karakteristikat natyrore të veçanta të bregut të Liqenit të Shkodrës që është pjesë e territorit administrativ të Bashkisë Koplík**
- Përmirësimi i gjendjes së bregut të Liqenit të Shkodrës*
 - Nxijtja dhe Zhvillimi i aktiviteteve turistike në këtë zone*
 - Promovimi i zonës së bregut të liqenit*
- A3. Promovimi dhe Zhvillimi i Korridorit Ekonomik Shkodër-Koplík sipas përcaktimeve të Strategjisë së Zhvillimit të rajonit Shkodër.**
- Vendosja e bashkëpunimit me komunat/rrethinat si Gruemira, Dobrac, si edhe me bashkinë e Shkodrës me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e këtij korridori*
 - Përgatitja e projekteve të detajuara për zhvillimin e mëtejshëm të këtij korridori*
 - Mbështetja me investime konkrete në pjesën e korridorit ekonomik brenda territorit të Koplíkut*
- A4. Promovimi dhe mbështetja në ngritjen dhe funksionimin efiakas të qendrës industriale të miratuar në veri të qytetit të Koplíkut**
- Përmirësimi i aksesit të qytetit të Koplíkut me zonën industriale të miratuar*
 - Rritja e shkalles së informimit të banorëve lidhur me reklamimin e qendrës*

Menaxhimi i Tokës

B1. Konsolidimin e qendrës urbane të zonës që korrespondon me qytetin e Koplíkut, sipas përcaktimeve të Planit të Ri Rregullues të qytetit si dhe transformimin e bulevardit kryesor që kalon përmes qytetit

- a. Rritjen e shkallës së informimit të banorëve lidhur me përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit.
- b. Përmirësimin e gjendjes së infrastrukturave fizike të qendrës së qytetit
- c. Përgatitjen e studimeve apo projekteve të ristrukturimit urban për zonën e qytetit

B2. Mbrojtjen e tokës bujqësore dhe ndalimi i ndërtimeve në të


- a. Rritjen e nivelit të kontrollit mbi ndërtimet e reja (Inspektorati i ndërtimit) në territorin e Bashkisë Koplík
- b. Prezantimi dhe konsolidimi i masave penalizuese si dhe njohja e komunitetit vendor me këto masa.
- c. Identifikimi i politikave fiskale të posaçme për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe orientimin e ndërtimeve në këto territore

B3. Rigjallërimi i territoreve ekzistuese të dëmtuara nga aktiviteti njerëzor si dhe mbrojtja e mjedisit në Bashkinë Koplík

- a. Identifikimi i zonave që kanë nevojë për ndërhyrje përmirësuese në mjedis
- b. Përmirësimi i gjendjes së mjediseve të dëmtuara (ndotura) në territorin e Bashkisë Koplík



Përmirësimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve

- 
- C1. Përmirësimin e gjendjes së rrjetit rrugor në Bashkinë Koplík duke u bazuar në skemën e propozuar në Planin e Përgjithshëm Rregullues si dhe në përmirësimin e komunikimit të banorëve në të gjithë territorin e Bashkisë.**
- a. Zbatimi i planit të rrjetit rrugor të propozuar në Planin e Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Koplíkut
 - b. Hartimi i projekteve të ndërhyrjes në rrjetin rrugor duke u bazuar në skemën e Planit Rregullues të propozuar
 - c. Kryerjen e investimeve përmirësuese për rrjetin rrugor të qytetit
- C2. Përmirësimi i gjendjes së ujësjellës kanalizimeve në territorin e Bashkisë Koplík**
- a. Përmirësimi i kushteve teknike dhe menaxhuese të drejtorisë së Ujësjellës Kanalizimeve në Bashkinë Koplík
 - b. Përmirësimi i gjendjes fizike të rrjetit të ujësjellës kanalizimeve në territorin e Bashkisë
 - c. Rritja e kapaciteteve të stafit të ndërmarrjes për menaxhimin dhe administrimin e ndërmarrjes
- C3. Përmirësimi i gjendjes së grumbullimit dhe depozitimit të mbeturinave urbane**
- a. Përgatitja e një Plani grumbullimi dhe menaxhimi të mbeturinave urbane në territorin e Bashkisë.
 - b. Identifikimi i një pike për depozitimin e mbeturinave

C4. Përmirësimi i gjendjes së shkollave dhe kopshteve në territorin e Bashkisë Koplík

- a. Evidentimi i nevojave për përmirësime fizike në shkollat e Bashkisë Koplík
- b. Përgatitja e projekteve teknike për financime të mundshme nga sektori shtetëror apo donatorë të ndryshëm
- c. Nxitja e forumeve vendore lidhur me mundësinë e rritjes së cilësisë së mësimdhënies në shkollat e bashkisë

C5. Gjelbërimi i mjediseve në Bashkinë Koplík

- a. Përmirësimi i kushteve fizike të mjediseve të gjelbra në territorin e bashkisë

C6. Ndriçimi i rrugëve

- a. Përmirësimi i gjendjes së ndriçimit rrugor në bashkinë Koplík

C7. Mirëmbajtja e Varrezave Publike

- a. Zgjerimi dhe përmirësimi i kushteve aktuale të varrezave publike në bashkinë Koplík

C8. Dekorimi i qytetit

- a. Përmirësimi i imazhit të qytetit dhe dekorimi i tij

C9. Rritja e shkalles së punësimit në Bashkinë Koplík.

- a. Rritja e kapaciteteve të banorëve vendas në Bashkinë Koplík
- b. Organizimi i punësimeve periodike për grupet në nevojë

Forcimi i Qeverisjes së Mirë

D1. Rritja e kapaciteteve të Bashkisë Koplík

- a. Riorganizimi administrativ i bashkisë Koplík
- b. Rritja e kapaciteteve teknike të stafit të bashkisë



D2. Përmirësimi i transparencës në proceset vendore të vendimmarrjes

- a. Shpërndarja zyrtare e informacionit lidhur me aktivitetet ekonomike të bashkisë Koplík
- b. Nxitja e pjesëmarrjes qytetare dhe informimi në mbledhjet e Këshillit Bashkiak në Koplík

D3. Zhvillimi i procesit të buxhetimit me pjesëmarrje në Bashkinë Koplík

- a. Ngritja e kapaciteteve vendore për organizimin e Buxhetimit me Pjesëmarrje në Koplík
- b. Organizimi i aktiviteteve vjetore periodike të Buxhetit me Pjesëmarrje në Bashkinë Koplík

Mobilizimi i Burimeve Financiare

F1. Rritja e të ardhurave Vendore të Bashkisë

- a. Krijimi dhe konsolidimi i baze së të dhënave për rritjen e bazës së taksave dhe tarifave në Bashkinë Koplík.

F2. Promovimi dhe rritja e investimeve të vendit dhe të huaja

- a. Përgatitja e materialeve promovuese për bashkinë Koplík.
- b. Organizimi i evenimenteve të ndryshme në mbështetje të biznesit në Bashkinë Koplík.

F3. Evidentimi dhe shfrytëzimi i burimeve të tjera financiare për Bashkinë Koplík

- a. Përgatitja e projekt propozimeve.

Instrumentat e Menaxhimit të Territorit

Në lidhje me përcaktimin dhe orientimin e shpërndarjes hapësinore të zonave të banimit, zonave mikse si edhe atyre ekonomike në Bashkinë e Koplíkut, në vijim paraqiten në këtë dokument, hartat me shpjegimet përkatëse.

Qëllimi i tyre është që të shprehin nëpërmjet organizimit të hapësirës territoriale objektivat kryesore ekonomike, sociale dhe ambientale të Bashkisë. Gjithashtu ato janë një instrument kyç për pjesëmarrjen e publikut, duke i ofruar qoftë aktorëve private apo publike mundësinë për të bashkevepruar bazuar në një vision të qartë dhe të integruar.

Nga ana tjetër, ato do të aftësojë mobilizimin e komunitetit më tej, drejt arritjes së qëllimeve të përbashkëta.

Pra qëllimi kryesor i këtyre materialeve të paraqitura është të orientojë zhvillimin, parë në këndvështrimin e menaxhimit të territorit. Në rastin e Bashkisë së Koplíkut, këto instrumenta synojnë:

- ❖ Të drejtojnë përdorimin e përgjithshëm të tokës duke përcaktuar kornizat për zhvillimin territorial të Bashkisë, Koplík.
- ❖ Të përcaktojnë korridoret kryesore të transportit
- ❖ Të përcaktojnë zonat mikse si dhe ato ekonomike
- ❖ Të merret parasysh në zhvillimin e ardhshëm të Bashkisë së Koplíkut, zonat me rëndësi të vecantë dhe me funksione specifike sikurse është edhe zona e mbrojtur e liqenit të Shkodrës.

A. Zonat e banimit

Zonat e banimit të paraqitura në hartë ndahen në:

1. Në llojin e parë janë të përfshira **Zonat e Konsolidimit Urban**, të cilat kanë nevojë dhe janë subjekt për hartimin e planeve të përgjithshme rregulluese në të ardhmen, të master planeve tematike apo studimeve të tjera specifike (si psh studime të detajuara pjesore etj...).
2. Në llojin e dytë është zona e propozuar suburbane, zonë që në zonimin funksional ekzistues në pjesën më të madhe të saj ka si funksion banimin, kurse në pjesën tjetër funksione mikse.
3. Në llojin e tretë janë të përfshira **Zonat e Ngrirjes Urbane**, të cilat nuk paraqesin nevojë për plane të përgjithshme rregulluese pasi propozimi konsiston në reduktimin dhe ndalimin e ndërtimeve të reja në të ardhmen.




B. Zonat e veçanta:

Zonat e veçanta të paraqitura në hartë ndahen në dy lloje:

- ❖ **Zonat miks dhe ekonomike:** këtu do të nënkuptojmë zonat e destinuara për zhvillimin e tregtisë, industrisë së lehtë të përpunimit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të zonës dhe si dhe shërbimeve përkatëse.
- ❖ **Zonat e gjelbra:** këtu përfshihen ato zona të gjelbra specifike të cilat kërkojnë një vëmendje të veçantë si psh; zona e mbrojtur e liqenit të Shkodrës apo parku i propozuar përgjatë brigjeve të liqenit.

Objektivat të cilat kanë orientuar propozimet e mësipërme janë:

- Të ndihmojnë në konsolidimin e zonave urbane
- Të ndihmojnë në dendësimin dhe rritjen e efikasitës së shërbimeve në zonat urbane



Forma dhe Metodologjia e Zbatimit të Planit Strategjik të Zhvillimit

Zbatimi i Planit Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Koplik është një proces i rëndësishëm gjithëpërfshirës, ku administrata e bashkisë ka rolin kryesor në organizimin dhe monitorimin e tij. Në mënyrë që të maksimalizohet efikasiteti i zbatimit të Planit është e rëndësishme që edhe struktura administrative e bashkisë të përputhet me nevojat dhe kërkesat që shtrun vetë dokumenti. Më konkretisht propozohet që:

- Të ngrihet grupi i zbatimit dhe monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Koplik, brenda strukturës administrative të Bashkisë, i cili do të jetë përgjegjës kryesor për koordinimin dhe zbatimin e nismave dhe aktiviteteve të propozuara në Planin e Veprimit. Në varësi të buxhetit të Bashkisë, grupi mund të përbehet nga përfaqësues të zyrave të ndryshme të administratës apo edhe nga specialistë të angazhuar rishtazi në këtë strukturë. Në të dy rastet grupi duhet të jetë nën drejtimin e nënkryetarit të Bashkisë apo edhe të vetë kryetarit. Në këtë mënyrë sigurohet vazhdimësia dhe lidhja e të gjithë proceseve në bashki me Planin Strategjik të Zhvillimit dhe propozimet e tij.
- Ngritja dhe konsolidimi i Departamentit të Koordinim Zhvillimit në Bashkinë Koplik, i cili do të angazhohet me përgatitjen e studimeve dhe projekt propozimeve të nevojshme për financim në funksion të aktiviteteve të propozuara sipas çdo fushe.
- Riorganizimi administrativ i Bashkisë Koplik duke u fokusuar në forcimin e strukturave administrative që merren me ndjekjen e angazhimeve strategjike në kuadër të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe monitorimin e performancës.
- Nisja e proceseve të bashkëpunimit institucional me komunitetet fqinje, Bashkinë Shkodër dhe Qarkun Shkodër për të nisur procesin për ndërtimin dhe konsolidimin e korridorit ekonomik Shkodër-Koplik si dhe koordinimin e ndërhyrjeve të përmirësimit fizik apo investimeve të ndryshme në të ardhmen.
- Përmirësimi i bazës së të dhënave territoriale, financiare dhe infrastrukturore në Bashki për t'i paraprire përgatitjes së një serie projektesh apo studimesh të nevojshme për zbatimin e mundshëm të Planit Strategjik i Zhvillimit.



- Rritja e kapaciteteve dhe nivelit të angazhimit të stafit të Bashkisë Koplík sidomos në aspektin e menaxhimit dhe monitorimit të territorit dhe infrastrukturave fizike nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme apo edhe përmirësimit të sistemit të raportimit dhe vlerësimit.
- Institucionalizimi i raporteve periodike të çdo departamenti lidhur me ecurinë e zbatimit të Planit Strategjik i Zhvillimit.

Zbatimi i suksesshëm i Planit Strategjik të Zhvillimit në Bashkinë Koplík kërkon domosdoshmërisht konsolidimin e një sistemi të mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi periodik. Në këtë mënyrë behet i mundur evidentimi i problemeve që mund të hasen gjatë zbatimit të Planit si dhe të ndërmerren ndryshimet apo adaptimet e nevojshme. Plani Strategjik i Zhvillimit i referohet një periudhe të shkurtër kohore 2008 – 2014 dhe në këtë mënyrë është tepër e rëndësishme që të shoqërohet me një proces të vazhdueshëm vlerësimi dhe përshtatjeje të nevojshme.

Duke qenë se Plani është një dokument strategjik në shërbim të institucionit të Bashkisë Koplík, është e natyrshme që zbatimi dhe monitorimi i tij të ecë në sinkron me proceset e përgjegdhjes dhe konsolidimit të strukturave bashkiake sipas fazave elektorale të pushtetit vendor në Shqipëri. Në këtë mënyrë sigurohet edhe përshtatja e propozimeve të Strategjisë së Zhvillimit si dhe monitorimi i zbatimit të tij me ciklet e përgjegdhjes dhe funksionimit të administratës vendore.

Plani i Veprimit për zbatimin e PSZH identifikon afatet e zbatimit të aktiviteteve të ndryshme si edhe aktorët përgjegjës përkatës. Secili nga këto aktivitete do të jetë objekt i raportimit dhe vlerësimit gjatë fazës së monitorimit

Skema e Propozuar e Monitorimit

Tema	Afati kohor (periodik për çdo vit)	Aktorët Përgjegjës
Vlerësim i aktiviteteve të gjashtëmuajorit sipas Planit të Veprimit të PSZH	Dhjetor- Janar	ZZhK
Takim i brendshëm stafi për diskutimin e raportit të progresit dhe rregullimeve të nevojshme	Gusht - Shtator	ZZhK – Kryetari i Bashkisë
Dëgjimi në Publik lidhur me rezultatet e zbatimit të PSZH-se Koplík	Shtator – Tetor	ZZhK
Vlerësimi Vjetor dhe Raportimi i Zbatimit të PSZH	Qershor- Korrik	Grupi i Punës së PSZH-së

Në fund të çdo vlerësimi, Grupi i Punës duhet të dorëzojë një raport përmbledhës, i cili do të paraqitet para Këshillit Bashkiak. Ky i fundit ruan të drejtën që për çdo rast të bëjë kërkesë për raportim shtesë nëse e gjykon të nevojshme.



PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË BASHKISË KOPLIK

P ë r m b l e d h j e